

MIRË SE VINI NË FRIDA & FRED

FRida & freD është një ndërtesë në qendër të Gracit për të gjithë fëmijët. Ne ofrojmë ekspozita tërheqëse, shfaqje teatrale dhe programe për fëmijët e moshës 3 deri në 12 vjeç. Eja të shohësh!

Orari

Të hënën, të mërkurën, të enjten nga ora 9.00-17.00
Të premten nga ora 9.00-19.00
Të shtunën, të dielën dhe ditët e festave nga ora 10.00-17.00
Të martën muzeu është i mbyllur

Muzeu është i mbyllur në datat: 1 janar, 25 dhjetor, 26 dhjetor, 31 dhjetor

Adresa

FRida & freD - Das Grazer Kindermuseum
Friedrichgasse 34
8010 Graz

Çmimet e biletave

Bileta për një ekspozitë

Fëmijët nga moshë 3 vjeç e sipër: 5,00 €

Të rriturit: 5,00 €

Familjet: 14,50 €

Familjet e pajisura me pasaportë familjare të landit Steiermark: 12,50 €

Bileta e kombinuar për të dy ekspozitat

Fëmijët nga moshë 3 vjeç e sipër: 7,50 €

Të rriturit: 7,50 €

Familjet: 19,00 €

Familjet e pajisura me pasaportë familjare të landit Steiermark: 17,00 €

Vizita e ekspozitës është e mundur në çdo kohë pa qenë e nevojshme për të lajmëruar më parë!

Çfarë të pret në muzeu ...

Mirë se vini në „Muzeun e çorapeve“ FRida & freD! Vendosi këpucët e tua në dollapin e këpucëve që ndodhet pas arkës dhe përjetoje ekspozitën zbathur, vetëm me çorape ose me mestet e shtëpisë që i ke marrë me vete.

Për një vizitë me nge të ekspozitës duhet të kesh në dispozicion të paktën një orë e gjysmë kohë. Për ekspozitat nuk është e nevojshme që të regjistrohesh, por vetëm për disa programe.

Të shtunën në orën dy (programet për ekspozitat). Çdo të shtunë në orën 14.00 zhvillohen tek ne programe speciale interesante në kuadrin e ekspozitave tona.

Teatri. Nga e enjtja deri të dielën në orën 16.00 japin shfaqje grupe teatri për ty. Rezervoje biletën tënde në numrin +43 (0)316 872 7700 dhe shfrytëzo biletën e kombinuar me ujllje për teatrin dhe ekspozitën. Shfaqjet e teatrit janë në gjuhën gjermane.

Kopshti FRida & freD. Prej datës 1.5. kopshti është i hapur për ty! Kopshti bën pjesë në zonën e ekspozitës dhe aty ka gjithmonë diçka për të bërë. Vetëm kur është kohë e mirë!

Zër vend në njërën nga tryezat ku bëhet pushim për të ngrënë diçka. Këtu ka automatë për kafe dhe pije. Gjëra të mira për të ngrënë mund të gesh në dyqanin e muzeut.

Lejohet të prekësh me dorë! Në ekspozitat tona ti mund të provosh gjithçka. Nëse ke pyetje dhe do të dish më shumë, drejtoju bluzëkuqve që të shoqërojnë gjatë ekspozitës.

Fotografimi. Natyrisht ti mund të fotografosh në muzeun tonë dhe t'i përdorësh fotografitë për qëllime private! Ti mund t'i nxjerrësh ato dhe në Facebook në faqen tonë të dashamirësve. Shikoje një herë!

Takime për grupe

FRida & freD ofron shërbime të ndryshme dhe programe për grupe. Për të prenotuar takime për grupe në gjuhën angleze, përkatësisht edhe për gjuhë të tjera, ju lutem kontaktoni:

Ingrid Stipper-Lackner

E-mail: ingrid.stipper-lackner@stadt.graz.at

Tel. +43 (0)316 872 7706

Çmimet për grupe (nga 15 persona e sipër)

4,00 € / person

Hyrja është falas për dy kujdestarët / et

